KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 13.12.2022, "Për formimin profesional në qendrat e formimit profesional të personelit hekurudhor që ushtron funksione sigurie, kushtet dhe procedurat për testimin, licencimin dhe certifikimin e makinistëve", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 174, datë 23.12.2022

bëhet korrigjimi si më poshtë:

"Në neni 8

Kërkesa për njohjen, rinovimin ose ndryshimin e një qendre formimi profesional

Të shtohet pika 5

5. Rregullat dhe procedurat për krijimin e Qendrave të Formimit Profesional nga administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore private miratohen me urdhër ministri.".